



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT

**RAPORTI 1 VJEÇAR PËR PROCESIN E KONSULTIMIT PUBLIK TË  
REALIZUAR NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT, PËR VITIN 2024**

**1. Përmbledhja ekzekutive** *(pasqyra e statistikave kryesore mbi konsultimet e kryera me mësimet e nxjerra, sfidat dhe mundësitë)*

Gjatë vitit 2024, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (MTM) ka realizuar 100% procesin e konsultimit publik për projekt-aktet e miratuara, objekt i konsultimit publik, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”.

Në zbatim të urdhrin nr. 3, datë 29.1.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik”, konsultimi publik është parashikuar të realizohet edhe për ato projektvendime të cilat vlerësohen të një interesi të lartë për publikun.

Gjatë vitit 2024, procesi i konsultimit publik është zhvilluar i plotë, për 24 projekt akte, 20 prej të cilave janë miratuar në Këshill të Ministrave.

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka publikuar pas procesit të konsultimit publik të projektakteve, edhe raportet përkatëse individuale për rezultatet e konsultimit publik për secilin projektakt të publikuar në regjistër, duke përbushur parimin e reagueshmërisë dhe llogaridhënies së këtij procesi.

Metodat për konsultimin e këtyre akteve janë përzgjedhur duke marrë parasysh kompleksitetin e akteve dhe implikimet që krijojnë tek qytetarët dhe grupet e interesit.

Nga monitorimi i platformës së Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK), vihet re se për vitin 2024 ka patur komente apo rekomandime për disa akte të konsultuara në këtë platformë. Komentet kanë ardhur me postë elektronike si dhe me shkresë zyrtare pranë MTM-së, nga grupet e interesit.

Procesi i Konsultimit Publik krahasuar me vitin e kaluar është përmirësuar. Format e përzgjedhura të konsultimit kanë rezultuar efektive duke mundësuar mbledhjen dhe reflektimin e reagimeve të palëve të interesit në draftin përfundimtar më qëllim krijimin e projekt akteve të gjithë pranuar dhe që reflektojnë interesin e publikut.

Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes nëpërmjet procesit të konsultimit publik mbetet sfida për t'u adresuar edhe më mirë nga institucioni ynë në të ardhmen.

## **2. Analiza e konsultimeve të kryera**

### **2.1. Numri i përgjithshëm i akteve për të cilat janë kryer konsultimet publike**

Numri i akteve të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik dhe që janë miratuar në Këshillin e Ministrave, gjatë vitit 2024 është 20, konkretisht:

1. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar;
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar;
3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar;
4. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
5. Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar;
6. Projektligji "Për një shtesë dhe ndryshime në ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar;
7. Projektligji "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10448, datë 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar;
8. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr. 43/2020, “Për aktivitetet e turizmit detar”,
9. Projektligji "Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesve të produkteve që gjenerojnë mbetje",
10. Projektvendimi “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur “Bredhi i Drenovës - Sinicë”, kategoria V”,
11. Projektvendimi “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor Rrushkull”, kategoria V”,
12. Projektvendim “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor Lumi Buna - Velipojë”, kategoria V”.
13. Projektvendimi “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor Pishë Poro - Nartë”, kategoria V”,
14. Projektvendimi “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor Liqeni i Pogradecit”, kategoria V”,
15. Projektvendimi “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Kuturman-Qafë Bushi”, kategoria V”,

16. Projektvendimi “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Krastë - Verjon”, kategoria V”,
17. Projektvendimi “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Guri i Nikës - Valamarë - Lenie”, kategoria V”,
18. Projektvendimi “Për shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Bjeshka e Oroshit”, kategoria V”,
19. Projektvendim “Për shpalljen “shpalljen “Peizazh i Mbrojtur Ujor/Tokësor Bishtkamëz”, kategoria V”,
20. Prejektvendimi “Për percaktimin e dokumentacionit të nevojshëm për pajisjen me licencë të sipërmarrësve që operojnë në treg me gazet serrë të fluoruara dhe pajisjet që përmbajnë këto gaze”.

Përzgjedhja e tyre është bërë në përputhje me ligjin nr. 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”. Në zbatim të nenit 1, të ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” përcaktohet shprehimisht se ky ligj rregullon procesin e konsultimit publik për projektligjet dhe projekt dokumentet strategjike, kombëtare dhe vendore.

Në zbatim të urdhrin nr. 3, datë 29.1.2021 të Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e udhëzuesit për procesin e konsultimit publik”, konsultimi publik është parashikuar të realizohet edhe për ato projektvendime të cilat vlerësohen të një interesi të lartë për publikun, pra jo vetëm për projektaktet që kanë detyrimin për t’iu nënshtruar këtij procesi në përputhje me parashikimet e nenit 1, të ligjit të sipërcituar.

### **2.1.1. Cili ishte numri i përgjithshëm i akteve të miratuara në një vit të caktuar?**

Projekt aktet e miratuara brenda vitit 2024, me propozim të MTM-së, janë 20, 9 projektligje dhe 11 projektvendime.

#### **i. Sa akte janë konsultuar dhe sa jo?**

20 projektakte kanë qenë objekt konsultimi dhe janë konsultuar në masën 100% nëpërmjet metodave të ndryshme konsultative.

#### **ii. Sa ligje me raporte VNR-je janë konsultuar?**

Për vitin 2024, rezulton që 7 projektligje janë konsultuar me raporte VNR-je, konkretisht:

1. Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar;
2. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar ;
3. Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar,
4. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar;
5. Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, i ndryshuar.

6. Projektligji "Për një shtesë dhe ndryshime në ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", i ndryshuar;
7. Projektligji "Për zbatimin e përgjegjësisë të zgjeruara të prodhuesit të produkteve që gjenerojnë mbetje."

**i. Për sa akte në a) Programin Analitik, b) PKIE, c) dokumente strategjike të sektorit, janë përdorur kriteret/përgjashtimet nga konsultimet publike? Cilat janë arsyet kryesore për të mos u konsultuar (nëse ka të tilla)?**

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka parashikuar në Program Analitik miratimin e 16 akteve, ku për 8 prej tyre aplikohen përgjashtimet e parashikuara në shkronjën "c", të nenit 4, të ligjit "*Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik*".

Në PKIE për vitin 2024 ishte parashikuar miratimi i 2 akteve.

Për 11 aktet e parashikuara në dokumentat strategjike sektorial/kombëtar, kriteret përgjashtuese janë aplikuar për 8 prej tyre.

**ii. Cila ishte struktura e akteve të konsultuara (sa projektligje, VKM, udhëzime, etj.)?**

Struktura e akteve që iu nënshtuan konsultimit publik janë 10 projektligje, 13 projektvendime dhe 1 projekt strategji.

**iii. A është përmirësuar situata në krahasim me vitin e kaluar (cilësoni)?**

Krahasuar me një vit më parë, konkretisht me konsultimin në vitin 2023, lidhur me kriteret apo përgjashtimet nga konsultimet publike rezulton se numri i akteve të përgjashtuara nga ky proces është më i ulët. Pasi në vitin 2023, kanë qenë të përgjashtuara më shumë akte administrative individuale apo me karakter normativ, ndërkohë që për vitin 2024 numërohen 7 akte të tilla, duke mos përfshirë kritere apo përgjashtime të tjera.

**b. Metodatat e konsultimit**


**i. Cilat ishin metodatat më të përdorura të konsultimit? (Jepni numrin e konsultimeve të kryera për secilën metodë - regjistri elektronik, posta elektronike, faqe interneti, takime publike, komitete këshillimore, etj.)**

Të gjitha projektaktet e miratuara për periudhën Janar-Dhjetor 2024 janë konsultuar nëpërmjet metodave të ndryshme të konsultimit:

Metodat e tjera të përzgjedhura për konsultim publik janë:

- Regjistri Elektronik të Njoftimit dhe Konsultimit Publik;
- posta elektronike,
- konsultim e këshillim gjatë hartimit të projekt aktit;
- tryeza të konsultimit publik pas përgatitjes së projektaktit;

**Grafik 1:** Metodatat e përdorura të konsultimit publik



## ii. Cila metodë konsultimi gjeneroi numrin më të madh të komenteve?

Metoda që gjeneroi numrin më të madh të komenteve ishte nëpërmjet postës elektronike, nga organizatat e shoqërisë civile të cilët zgjedhin që komentet e tyre t'i dërgojnë në adresën e koordinatorit të konsultimit publik apo personit tjetër të kontaktit, që është sipas rastit, specialisti përgjegjës për hartimin e projektaktit. Gjithashtu edhe nga zhvillimi i dëgjësive publike janë gjeneruar një numër I konsiderueshëm komentesh.

## iii. A organizoi institucioni konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit? Nëse po, në sa raste?

Institucioni ka zhvilluar konsultime paraprake në fazat e hershme të hartimit për projektligjet e mëposhtme:

- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar,
- Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar,
- Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar,

- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar.

**c. Kohëzgjatja e konsultimeve**

- i. Sa konsultime ishin të hapura për 20 ditë pune siç kërkohet nga ligji? Cila ishte periudha më e gjatë apo më e shkurtër e kohëzgjatjes së konsultimeve?**

Për të gjithë projektaktet që i janë nënshtruar procesit të konsultimit publik, për vitin 2024, nëpërmjet publikimit në RENJK, është respektuar afatin ligjor prej 20 ditë pune.

**ii. Cila ishte kohëzgjatja mesatare e konsultimit?**

Kohëzgjatja mesatare e konsultimit ka qenë minimalisht një muaj, pra 30 ditë kalendarike, referuar afatit të publikimit në RENJK të projektaktit.

**iii. A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?**

Edhe për këtë periudhë, konsultimi publik në Regjistrin Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike (RENJK) për të gjitha aktet e miratuara gjatë vitit 2024 u realizua në përputhje me parashikimin ligjor lidhur me respektimin e afatit prej 20 ditësh pune duke filluar nga data e publikimit.

**d. Palët e interesuara të përfshira**

- 2.4.1 Sa aktorë të jashtëm, jo-qeveritarë morën pjesë për hartimin e akteve si anëtarë të caktuar të grupeve të punës/organeve këshillimore në vitin e caktuar?**

Për çdo projekt akt të konsultuar për vitin 2024, kanë kontribuar ekspertë të jashtëm.

- 2.4.2 Cila ishte struktura e anëtarëve të jashtëm të grupeve të punës (ekspertë individualë, OSHC, kompani, etj.)**

Ekspert individualë.

- 2.4.3 Sa palë të interesuara morën pjesë/dhanë komente në konsultime të hapura të realizuara për projekt-aktet në vitin e caktuar?**

73 palë të interesuara morën pjesë në konsultime të hapura, të realizuara për konsultimin e projekt-akteve.

#### **2.4.4 Cila ishte struktura e kontribuuesve në konsultimet publike, sa persona, sa persona juridikë (ndërmarrje, shoqata, etj.)?**

Struktura e kontribuueseve ishte si më poshtë:

1. Unione dhe shoqata
2. Organizata të mjedisit
3. Njësitë e qeverisjes vendore
4. Këshill Konsultativ

#### **2.4.5 A është përmirësuar situata në krahasim me vitet e kaluara?**

Vlerësohet se situata në krahasim me vitet e kaluara ka ardhur duke u përmirësuar. Kjo gjë konstatohet nga rritja e numrit të pjesëmarrësve në procesin e konsultimit, të organizuar nga ministria. Gjithashtu, një tjetër tregues rezulton dhe nga monitorimi i faqes së Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike, pasi vërehet një rritje e numrit të qytetarëve që ndjekin projekt aktet e publikuara në të.

##### **e. Rekomandimet dhe komentet e marra**

##### **i. Sa është numri i rekomandimeve dhe komenteve të marra gjithsej dhe mesatarja për çdo konsultim?**

Për projektligjet e miratuara për vitin 2024, numri i rekomandimeve dhe komenteve është si vijon:

- Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.93/2015, “Për turizmin”, i ndryshuar, 27 komente, 19 refuzuar, 6 pranuar, 2 pranuar pjesërisht.
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.162/2014, “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”, i ndryshuar ; 1 koment, refuzuar
- Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” i ndryshuar; 1 koment refuzuar
- Projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9587, datë 20.7.2006, “Për mbrojtjen e biodiversitetit”, i ndryshuar; 1 koment refuzuar
- Projektligji “Për disa ndryshime në ligjin nr.10431, datë 9.6.2011, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, 1 koment refuzuar
- Projektligji "Për një shtesë dhe ndryshime në ligjin nr.10463, datë 22.9.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar; 1 koment refuzuar.
- Projektligjin "Për zbatimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit", 5 komente gjithsej, 3 pranuar, 2 pranuar pjesërisht.

##### **ii. Sa prej tyre u pranuan, u pranuan pjesërisht ose u refuzuan?**

Për 7 nga projektligjet e miratuara për vitin 2024, numri i rekomandimeve dhe komenteve ishte 37, nga të cilat 19 u refuzuan, sepse nuk ishin rekomandime konkrete që lidheshin me përmbajtjen e projektaktit.

**iii. Cila është tendenca nëse krahasohet me vitet e kaluara?**

Tendenca e pranimit të komenteve dhe sugjerimeve të dhëna nëpërmjet RENJK, takimeve publike apo emaileve mbetet e kënaqshme, pasi shumica e komenteve të marra është reflektuar.

**iv. Sa raporte të VNR-së janë ndryshuar/përditësuar në bazë të informacionit/të dhënave të marra gjatë konsultimit publik?**

Nuk ka patur ndryshime.

**f. Raportet mbi rezultatet e konsultimit**

**i. Sa raporte konsultimi publikoi institucioni?**

Për të gjitha aktet e publikuara në RENJK, për të cilat afati i konsultimit është mbyllur dhe është bërë vlerësimi i komenteve nga strukturat teknike, institucioni ka publikuar raportet individuale të konsultimit.

**ii. Nëse disa nuk u publikuan, cilat janë arsyet?**

Nuk ka patur raste të mospublikimit.

**g. Vetëvlerësimi i institucionit në lidhje me Indeksën e cilësisë së performancës institucionale në përputhje me kërkesat e ligjit për njoftimin dhe konsultimin publik (Jepni informacion për rezultatin mesatar për të gjitha aktet e institucionit, subjekt të konsultimeve publike, bazuar në pikët e rezultateve në Shtojcën 5c)**

Indeksi performancës për cilësinë e konsultimit publik për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit është 8, për secilin nga projektaktet e miratuara.

**3.Sfidat dhe mundësitë për të ardhmen** (Cilat janë sfidat kryesore në organizimin dhe zbatimin e konsultimeve në ministri dhe si duhet dhe do të adresohen ato në periudhën tjetër të raportimit?)

Sfidat kryesore që paraqet konsultimi publik vazhdojnë të lidhen edhe këtë vit më së shumti me një përfshirje akoma më të madhe të publikut në këtë proces. Sërish nuk reflektohet një



kulturë maksimale e angazhimit në proceset e hartimit të politikave, edhe pse ka përmirësime të dukshme.

Në vijim, me qëllim përmirësimit cilësisë së procesit, synohet ndërgjegjësimi edhe më shumë përmes informimit më aktiv të publikut për përfshirjen në procesin e konsultimit publik, në përshtatje me zhvillimet më të fundit të mjeteve të informacionit.